

LIGJI Nr. 05/L-117

PËR AKREDITIM

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton:

LIGJ PËR AKREDITIM

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

1. Ky ligj përcakton parimet e akreditimit dhe rregullat për akreditimin e trupave të vlerësimit të konformitetit që kryejnë aktivitete të vlerësimit të konformitetit në Kosovë.
2. Ky ligj është në pajtim të plotë me Rregulloren (EC) Nr. 765/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 9 korrik 2008 e cila përcakton kërkesat për akreditim dhe mbikëqyrjen e tregut dhe shfuqizimin e Rregullores (EEC) Nr. 339/93 për aq sa ka të bëjë me akreditimin.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Ky ligj është i zbatueshëm për akreditimin e trupave për vlerësimin e konformitetit që kryejnë aktivitete të vlerësimit të konformitetit në Kosovë.

**Neni 3
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. **Akreditim** – vërtetim nga organi shtetëror për akreditim që një trup për vlerësimin e konformitetit i plotëson kërkesat e përcaktuara me standardet e harmonizuara dhe, aty ku është e aplikueshme, edhe kërkesa të tjera shtesë, përfshirë ato të përcaktuara në skemat relevante sektoriale, për të kryer aktivitete specifike për vlerësimin e konformitetit;

1.2. **Organ Shtetëror për Akreditim** – organ i vetëm në një shtet i cili kryen akreditime me kompetenca që burojnë nga shteti;

1.3. **Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës (në tekstin e mëtejme DAK)** – i vetmi organ shtetëror për Akreditim në Kosovë;

- 1.4. **Logo e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës** – logo e përdorur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës për identifikimin e saj siç është përcaktuar me ligjin përkatës për simbole shtetërore;
- 1.5. **Vlerësim i konformitetit** – procesi i cili demonstroi se kërkesat e specifikuar për një produkt, proces, shërbim, sistem, person apo trup janë të plotësuar;
- 1.6. **Trup për vlerësimin e konformitetit** – trupi që kryen aktivitete të vlerësimit të konformitetit përfshi kalibrimin, testimin, certifikimin dhe inspektimin;
- 1.7. **Specifikim Teknik** – dokument i cili përshkruan kërkesat teknike që një produkt, proces apo shërbim duhet plotësuar;
- 1.8. **Standard i harmonizuar** – standard evropian i miratuar në bazë të kërkesës së Komisionit të BE-së për zbatimin e legjislacionit të harmonizuar të Bashkimit Evropian;
- 1.9. **Vlerësim i ndërsjellë** – procesi i vlerësimit të një organi shtetëror të akreditimit nga organizma të tjerë shtetëror të akreditimit, që kryhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organizmat e tjerë Evropiane dhe ndërkombëtarë të akreditimit, dhe sipas rastit, edhe me specifikimet teknike sektoriale;
- 1.10. **Rregullat e Akreditimit** - rregullat e trupit kombëtar të akreditimit që e përcaktojnë procesin e akreditimit, të drejtat dhe obligimet e atyre që janë të përfshirë në procesin e akreditimit, dhe kriteret/kushtet që duhet plotësuar nga trupi i vlerësimit të konformitetit për ta fituar akreditimin;
- 1.11. **Certifikata e akreditimit** – dokument i cili deklaron se një trup për vlerësimin e konformitetit i plotëson të gjitha kërkesat e cekura në rregullat e akreditimit, dhe është kompetent për të kryer aktivitete për vlerësimin e konformitetit për fushat specifike;
- 1.12. **Simbol i akreditimit** – simbol i lëshuar nga organi i akreditimit për t'u përdorur nga trupi për vlerësimin e konformitetit për të treguar statusin e vet të akredituar;
- 1.13. **Apelim** – kërkesë nga një trup për vlerësimin e konformitetit për rishikimin e çdo vendimi të pafavorshëm të marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës;
- 1.14. **Ankesë** – shprehje e pakënaqësisë nga çdo person ose organizatë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës, lidhur me aktivitetet e saj, apo aktivitetet e një trupi të akredituar për vlerësimin e konformitetit;
- 1.15. **Mbikëqyrje** – një varg aktivitete, përveç rivlerësimit, të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës, për monitorimin e plotësimit të vazhdueshëm të kërkesave për akreditim nga trupat e akredituar për vlerësimin e konformitetit;
- 1.16. **Reduktim i akreditimit** – proces i tërheqjes së akreditimit për një pjesë të fushës së akreditimit;
- 1.17. **Zgjerim i akreditimit** – proces i zgjerimit të fushës së akreditimit;
- 1.18. **Pezullim i akreditimit** – proces i cili e bën përkohësisht akreditimin jo të vlefshëm,

plotësisht ose për një pjesë të fushës së akreditimit;

1.19. **Tërheqje e akreditimit** – proces i tërheqjes së plotë të akreditimit;

1.20. **Konsulencë** – pjesëmarrje në cilindo aktivitet të trupit për vlerësimin e konformitetit që i nënshtrohet akreditimit;

1.21. **Ministria** – ministria përkatëse për tregti dhe industri.

Neni 4

Aplikimi i akreditimit

1. Akreditimi i trupave për vlerësimin e konformitetit është vullnetar.
2. Akreditimi mund të bëhet i detyrueshëm për kryerjen e aktiviteteve specifike për vlerësimin e konformitetit nëse është përcaktuar në një ligj apo rregullore specifike.
3. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës kryen aktivitetet e veta në baza jo fitimprurëse.
4. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për akreditimin e trupave që kryejnë veprimtari të vlerësimit të konformitetit në fushat të cilat janë të rregulluara me akte ligjore të Kosovës dhe për akreditimin e trupave që kryejnë veprimtari të vlerësimit të konformitetit në fushat ku nuk janë të rregulluara me akte ligjore të Kosovës.

KAPITULLI II

ORGANIZIMI I AKREDITIMIT NË KOSOVË

Neni 5

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës

1. Aktivitetet e akreditimit kryhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës, e themeluar si organ i pavarur i administratës shtetërore, i cili vepron në kuadër të Ministrisë.
2. Struktura dhe organizimi i DAK siguron paanshmëri dhe objektivitet në marrjen e vendimit për akreditim.
3. Ligji për Administratën Shtetërore i Republikës së Kosovës do të zbatohet për themelimin, organizimin dhe funksionimin e DAK-ut, përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë ligj.
4. Organizimi dhe funksionimi i DAK-ut rregullohet përmes aktit nënligjor i miratuar nga Qeveria e Kosovës.

Neni 6

Detyrimet e DAK

Sipas dispozitave të këtij ligji DAK duhet të zbatojë edhe standardin shtetëror të Kosovës i cili e miraton standardin e harmonizuar përkatës Evropian dhe standardin ndërkombëtar, si

dhe dokumentet e lëshuara nga organizatat Evropiane dhe ndërkombëtare për akreditim, ku përcaktohen kërkesat e përgjithshme për organe të akreditimit të cilët akreditojnë trupa për vlerësimin e konformitetit.

Neni 7

Fushat e aktivitetit të akreditimit nga DAK

1. Fushat e aktivitetit të akreditimit janë si në vijim:

- 1.1. akreditimi i laboratorëve testues dhe kalibrues;
- 1.2. akreditimi i laboratorëve mjekësor;
- 1.3. akreditimi i trupave inspektues;
- 1.4. akreditimi i trupave për certifikimin e produkteve;
- 1.5. akreditimi i trupave certifikues të sistemeve të menaxhimit (cilësisë, ambientit etj.);
- 1.6. akreditimi i trupave certifikues të personelit; dhe
- 1.7. akreditimi i trupave tjerë për vlerësimin e konformitetit.

Neni 8

Kompetencat e DAK

1. DAK kryen detyrat si në vijim:

- 1.1. vlerëson përmes procesit të akreditimit kompetencën e trupave për vlerësimin e konformitetit;
- 1.2. mbikëqyrë plotësimin e vazhdueshëm të kërkesave për kryerjen e aktiviteteve specifike për vlerësimin e konformitetit;
- 1.3. i ofron ekspertizë dhe trajnimet organeve administrative shtetërore për çështjet të cilat lidhen me akreditimin e trupave për vlerësimin e konformitetit;
- 1.4. vendos dhe vë në dispozicion të publikut Rregullat e Akreditimit, bazuar në standardet përkatëse shtetërore të Kosovës të adoptuara nga standardet Evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe dokumentet e lëshuara nga organizatat Evropiane dhe ndërkombëtare për akreditim;
- 1.5. mban dhe vë në dispozicion të publikut Regjistrin e Trupave të Akredituar për Vlerësimin e Konformitetit;
- 1.6. vë në dispozicion të publikut informacione mbi aktivitetet e veta dhe për rezultatet e vlerësimit të ndërsjelltë;

1.7. përfaqëson dhe merr pjesë në aktivitetet e organizatave evropiane dhe ndërkombëtare për akreditim.

Neni 9

Parimi i mos konkurrencës

1. DAK nuk ofron apo kryen shërbime të cilat ofrohen nga trupat për vlerësimin e konformitetit.
2. DAK nuk do të ofrojë shërbime të konsulencës, dhe nuk do të ketë përfitime financiare ose menaxheriale në një trup për vlerësimin e konformitetit.
3. DAK nuk iu konkurren organeve tjera shtetërore për akreditim. Nuk ofron shërbime jashtë kufijve të Kosovës, përveç në raste dhe sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 3. të nenit 24 të këtij Ligji.

Neni 10

Burimet financiare të DAK

1. Burimet financiare për aktivitetet e DAK-ut do të sigurohen nga buxheti shtetëror.
2. Donacionet nga trupat për vlerësimin e konformitetit nuk lejohen.
3. Shuma e nevojshme e burimeve financiare për funksionimin e DAK do të vendoset në bazë të aktiviteteve të përcaktuara në Planin Vjetor të Punës.
4. Ministria dhe ministria përkatëse për financa do të sigurojnë burimet e duhura financiare për DAK për:
 - 4.1. kryerjen e duhur të detyrave të saj;
 - 4.2. pagesën e anëtarësimit në organizata evropiane dhe ndërkombëtare të akreditimit;
 - 4.3. pjesëmarrjen në aktivitete të organizatave evropiane dhe ndërkombëtare të akreditimit;
 - 4.4. pagesën e personelit të jashtëm për akreditim.

Neni 11

Tarifat e akreditimit

1. Shërbimet e akreditimit të DAK-ut, paguhet në bazë të shpenzimeve për punën e kryer.
2. Tarifat e Akreditimit do të përcaktohen nëpërmjet akteve nënligjore të nxjerra nga Ministria.

Neni 12 **Organet e DAK**

1. Organet e DAK janë:
 - 1.1. Drejtori i Përgjithshëm;
 - 1.2. Këshilli Profesional;
 - 1.3. Këshilli i Akreditimit.

Neni 13 **Drejtori i Përgjithshëm**

1. DAK menaxhohet nga Drejtori i Përgjithshëm.
2. Drejtori i Përgjithshëm i DAK merr vendimin për Akreditim.
3. Emërimi, shkarkimi, funksionimi dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm zbatohen në pajtim me dispozitat e Ligjit përkatës të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores për procedurën e emërimit për pozita të larta drejtuese.
4. Rekrutimi i zyrtarëve të DAK bëhet në pajtim me kushtet dhe kriteret e specifikuar në dispozitat e aplikueshme të Ligjit për Shërbyes Civil të Republikës së Kosovës.

Neni 14 **Këshilli Profesional**

1. DAK themelon Këshillin Profesional në mënyrë që të sigurohet përfshirje efektive dhe e balancuar e të gjitha palëve të interesit, dhe ruajtjes së paanshmërisë, transparencës dhe korrektësisë në mes palëve të interesit në procesin e akreditimit.
2. Këshilli Profesional i ofron mendime profesionale dhe rekomandime Drejtorit të Përgjithshëm të DAK sa i përket zhvillimit të sistemit të akreditimit në Kosovë, përfshi politikat, procedurat, planet vjetore dhe afatgjata, zgjerimin e aktiviteteve të akreditimit dhe burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare.
3. Drejtori i Përgjithshëm i DAK nuk merr vendime për çështjet e referuara në paragrafin 2. të këtij neni pa rekomandime të mëhershme të Këshillit Profesional.
4. Drejtori i Përgjithshëm i DAK-ut, emëron anëtarët e Komisionit të Apelit, nga lista e rekomanduar e Këshillit Profesional.
5. Mënyra e themelimit të Këshillit Profesional, fushëveprimi, si dhe përzgjedhja dhe caktimi i anëtarëve të vet rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

Neni 15

Këshilli i Akreditimit

1. Drejtori i Përgjithshëm i DAK-ut, themelon Këshillin e Akreditimit, anëtarët e të cilit do të jenë të tjerë prej atyre që kanë kryer vlerësimin e trupit për vlerësimin e konformitetit.
2. Këshilli i Akreditimit i ofron rekomandime Drejtorit të Përgjithshëm për marrjen e vendimeve për akreditim për secilin rast të veçantë të vlerësimit.
3. Mënyra e themelimit të Këshillit të Akreditimit, fushëveprimi si dhe përzgjedhja dhe caktimi i anëtarëve të vet do të rregullohet me akt nënligjor të lëshuar nga Ministria.

Neni 16

Organi mbikëqyrës i DAK-ut

1. Ministria është organ përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së DAK-ut, duke përfshirë edhe monitorimin e plotësimit të kërkesave të përcaktuara në nenin 6 të këtij Ligji, duke marrë parasysh konfidencialitetin e të dhënave të trupave për vlerësimin e konformitetit që janë klientë të DAK-ut.
2. Ministria do ta marrë parasysh rezultatin e vlerësimit të ndërsjellë gjatë mbikëqyrjes së DAK-ut të referuar në paragrafin 1. të këtij neni.

KAPITULLI III

PROCESI I AKREDITIMIT

Neni 17

Procedura e akreditimit

1. DAK do të vlerësojë, kurdo që kërkohet nga trupi për vlerësimin e konformitetit, në qoftë se ai trup për vlerësimin e konformitetit është kompetent për të kryer aktivitete specifike të vlerësimit të konformitetit.
2. Akreditimi kryhet bazuar në aplikimin e parashtruar nga trupi për vlerësimin e konformitetit.
3. DAK dhe trupi për vlerësimin e konformitetit rregullojnë me kontratë të drejtat dhe obligimet e ndërsjella sa i përket marrjes së certifikatës së akreditimit dhe mbajtjes së akreditimit.
4. DAK do të ruajë konfidencialitetin e informacionit të marrë në të gjitha rastet e akreditimit.
5. DAK do t'i lëshojë certifikatën e akreditimit trupit për vlerësimin e konformitetit aty ku konstatohet të jetë kompetente.
6. Nëse gjatë finalizimit të procesit të akreditimit konstatohet se Trupa e Vlerësimit të Konformitetit ka dështuar në plotësimin e disa kërkesave për akreditim, DAK nxjerr vendim për refuzim të akreditimit ose për dhënie të akreditimit duke e zvogëluar fushën e akreditimit.

7. Vlefshmëria e certifikatës së konformitetit lëshohet në afat jo më të gjatë së katër (4) vjet. Trupi i akredituar për vlerësimin e konformitetit duhet vazhdimisht të jetë në pajtim me kërkesat e akreditimit për periudhën gjatë së cilës certifikata e akreditimit është e vlefshme.

8. DAK do t'i hartojë dhe do të vejë në dispozicion të publikut Rregullat e Akreditimit për trupat për vlerësimin e konformitetit, ku specifikohet hollësisht procesi i akreditimit.

9. DAK i përcakton procedurat e nevojshme, përmes akteve të brendshme, për të siguruar menaxhim efikas dhe të duhur të kontrolleve të brendshme të të gjithë procesit të akreditimit.

Neni 18

Simboli i akreditimit

DAK do të lejojë trupin e akredituar për vlerësimin e konformitetit të përdorë simbolin e akreditimit në mënyrë që të tregohet statusi i vet i trupit të akredituar për vlerësimin e konformitetit.

Neni 19

Mbikëqyrja e trupit të akredituar për vlerësimin e konformitetit

1. DAK do të monitorojë trupin për vlerësimin e konformitetit të cilit ia ka lëshuar certifikatën e akreditimit duke kryer mbikëqyrje të rregullta. Gjatë mbikëqyrjes, DAK do të vendosë për vazhdimin e akreditimit ose të ndonjë ndryshimi në fushën e akreditimit.

2. Në qoftë se një trup i akredituar për vlerësimin e konformitetit kërkon zgjerimin e fushës së akreditimit, vlerësimi i kompetencës në fushën e zgjeruar mund të bëhet gjatë mbikëqyrjes.

3. Aty ku DAK konstaton se trupi për vlerësimin e konformitetit i cili ka marrë certifikatën e akreditimit nuk është më kompetent për të kryer aktivitete specifike të konformitetit apo ka kryer shkelje të rëndë të obligimeve të veta, DAK do të merr masat e duhura brenda afatit kohor që të reduktojë, pezullojë ose të tërheqë akreditimin.

4. Trupa e Vlerësimit të Konformitetit mund të parashtrij një kërkesë për apelim kundër vendimit të DAK-ut për ngushtim të fushës së akreditimit, pezullim ose tërheqje të akreditimit.

5. Gjatë vlerësimit, DAK do të verifikojë nëse trupi për vlerësimin e konformitetit e ka kryer vlerësimin e konformitetit në mënyrën e duhur, duke marrë parasysh madhësinë e kompanisë, sektorin në të cilin operon kompania, strukturën e vet, ndërlikueshmërinë e teknologjisë së prodhimit dhe masën dhe natyrën serike të procesit të prodhimit.

Neni 20

Grupet punuese

1. DAK mund të themelojë grupe punuese profesionale në baza të pozitës ose në baza të përkohshme për qëllime të ofrimit të ekspertizës për çështje specifike në procedurën e akreditimit, si në vijim: komitete teknike, komitete të vlerësimit të personave dhe në fusha të tjera.

2. Komiteti teknik është organ teknik i cili ofron ekspertiza teknike në fusha të caktuara të akreditimit.

3. Komiteti për vlerësimin e personave është një organ i cili vlerëson dhe monitoron personat e përfshirë në procesin e akreditimit sa i përket kualifikimit të tyre, kompetencave dhe përvojës si dhe performancën e tyre në fusha të caktuara dhe fushëveprime.

Neni 21

Procedura e apelit

1. DAK do të hartojë procedurën për zgjidhjen e apeleve.
2. Apelet do të shqyrtohen nga Komisioni për Apele i përcaktuar në paragrafin 4. të nenit 14 të këtij ligji, i cili i bën rekomandime Drejtorit të Përgjithshëm.
3. Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm është i plotfuqishëm, ndërsa kundër tij mund të iniciohet konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente.

Neni 22

Procedura e ankesave

1. DAK do të hartoj procedurën për zgjidhjen e ankesave lidhur me aktivitetet e saj apo me aktivitetet e trupit për vlerësimin e konformitetit të akredituar nga DAK.
2. Ankesa zgjidhet nga Drejtori i Përgjithshëm i DAK.

KAPITULLI IV

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 23

Aktivitetet ndërkombëtare të DAK

1. DAK do t'i plotësojë standardet që të jetë anëtare e organizatave Evropiane dhe Ndërkombëtare të akreditimit dhe do të marrë pjesë në aktivitetet e tyre.
2. DAK do t'i nënshtrohet vlerësimit të ndërsjellë të organizuar nga organizata evropiane për akreditim, dhe do të nënshkruajë marrëveshje për njohje të ndërsjellë të akreditimit.
3. Në Kosovë pranohet ekuivalenca e shërbimeve të kryera nga ato trupa të akredituar të cilët i janë nënshtruar me sukses vlerësimit të ndërsjellë të referuar në paragrafin 2. të këtij neni.
4. Si rrjedhojë e paragrafit 3. të këtij neni, pranohen certifikatat e akreditimit të atyre trupave të akredituar dhe vërtetimi i lëshuar nga trupat për vlerësimin e konformitetit nga ta.

Neni 24

Akreditimi përtej kufijve

1. Trupi për vlerësimin e konformitetit mund të kërkojë akreditim nga një organ shtetëror për akreditim jashtë Kosovës vetëm në rastet si në vijim:

1.1. Kur DAK nuk kryen akreditime sa i përket aktiviteteve për vlerësimin e konformitetit për të cilat kërkohet akreditimi;

1.2. Kur DAK nuk i është nënshtruar me sukses vlerësimit të ndërsjelltë të përcaktuar në nenin 23 paragrafin 2, sa i përket aktiviteteve për vlerësimin e konformitetit për të cilin kërkohet akreditimi.

2. DAK mund të pranojë kërkesa për akreditim nga trupa për vlerësimin e konformitetit jashtë Kosovës sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni.

3. Kur DAK pranon një kërkesë për akreditim nga një trup për vlerësimin e konformitetit i vendosur në një shtet tjetër, DAK duhet të informojë organin shtetëror për akreditim të shtetit në të cilin është vendosur trupi për vlerësimin e konformitetit. Në raste të tilla, organi shtetëror për vlerësimin e konformitetit i atij shteti në të cilin është vendosur trupi për vlerësimin e konformitetit mund të merr pjesë si vëzhgues.

4. DAK mund të kërkojë nga një organ tjetër shtetëror për akreditim të kryejë aktivitetin e vlerësimit. Në raste të tilla, vendimi për akreditim do të merret nga DAK e cila po ashtu lëshon certifikatën e akreditimit.

KAPITULLI V DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 25 Dispozitat kalimtare

Qeveria e Kosovës do t'i sigurojë DAK-ut hapësirat e nevojshme të punës si dhe pajisjet, njëkohësisht DAK trashëgon nga Drejtoria e Akreditimit e Kosovës të gjitha mjetet dhe pajisjet e parapara për të kryer detyrat që lidhen me akreditimin si dhe punonjësit që kryejnë këto aktivitete.

Neni 26 Vlefshmëria e certifikatës së akreditimit

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, certifikatat e akreditimit të lëshuara nga Drejtoria e Akreditimit e Kosovës (DAK) mbesin të vlefshme gjatë tërë periudhës së vlefshmërisë së tyre, përveç nëse veprohet në kundërshtim me nenin 19 paragrafi 3. të këtij Ligji.

2. Aktivitetet e akreditimit të cilat kanë filluar përpara hyrjes në fuqi të këtij Ligji do të finalizohen në pajtim me këtë ligj dhe me rregulloret e referuara në nenin 28 të këtij Ligji.

Neni 27 Nxjerrja e akteve nënligjore

Qeveria dhe Ministria do të nxjerrin aktet nënligjore të përcaktuara me këtë ligj në afat kohor prej një 1 viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 28**Aktet nënligjore të zbatueshme deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore**

1. Me kusht që mos të jenë në kundërshtim me këtë ligj dhe deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore për zbatimin e duhur të këtij ligji, aktet nënligjore të zbatueshme do të vazhdojnë të mbesin në fuqi si në vijim:

1.1. Rregullorja (MTI) Nr. 02/2016 për Këshillin e Akreditimit;

1.2. Rregullorja (MTI) Nr. 04/2016 për Këshillin Profesional të Akreditimit;

1.3. Rregullorja Nr. 29/2012 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në pjesët ku rregullohet organizimi i "Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës" (nenet 45 deri 50);

1.4. Udhëzim Administrativ Nr. 19/2012 për caktimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimin e emblemës së akreditimit;

1.5. Udhëzim Administrativ Nr. 04/2013 për caktimin e tarifave për akreditim.

Neni 29**Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji shfuqizohet: Ligji Nr. 03/L-069 për Akreditim dhe Ligji Nr. 04/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-069 për Akreditim.

Neni 30**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

Ligji Nr. 05/L-117

20 dhjetor 2016

Shpallur me dekretin Nr. DL-001-2017, datë 05.01.2017 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi.